

**Nr. 604/9, datë 19.12.2022**

Agjencia Shtetërore për shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarëse të furnizimit me ujë të fshatrave “Velabisht–Stratrovë–Remanicë–Veterik”.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “arë” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat, të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 188,993 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE  
**Egra Ibrahimi**

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “NDËRTIMI I LINJËS KRYESORE DHE SHPËRNDARËSE TË FURNIZIMIT ME UJË TË FSHATRAVE ‘VELABISHT–STRATROVË–REMANICË–VETERIK’”

| Nr. | PRONARI      |        |         |                 |          |                  |                |        |               | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM,<br>SIPAS LLOJIT TË PASURISË |             |                  |                       |                    | Shënime                |  |
|-----|--------------|--------|---------|-----------------|----------|------------------|----------------|--------|---------------|--------------------------------------------------------|-------------|------------------|-----------------------|--------------------|------------------------|--|
|     | Emri         | Atësia | Mbiemri | Zona kadastrale | Nr. pas. | Lloji i pasurisë | Sip. totale m² | Arë m² | Sipërfaqja m² | Gjimi (lek/<br>m²)                                     | Vlera (lek) | Vlera e kulturës | Vlera e dru-frutoreve | Vlera totale (lek) |                        |  |
| 1   | Dilaver      | Qemal  | Gorezi  | 3977            | 416/4    | Arë              | 4600           | 4600   | 761           | 203                                                    | 154483      |                  |                       | 154483             | Konfirmuar nga ASHK-ja |  |
| 2   | Ramadan      | Faik   | Shyti   | 3977            | 415/8    | Ullishte         | 2600           | 2600   | 170           | 203                                                    | 34510       |                  |                       | 34510              | Konfirmuar nga ASHK-ja |  |
|     |              |        |         |                 |          |                  |                |        |               |                                                        |             |                  |                       |                    |                        |  |
|     | Shuma totale |        |         |                 |          |                  |                |        |               |                                                        |             |                  |                       | 188993             |                        |  |